# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 01/30**
**Datë: 12.05.2020**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafit 4 të nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 maj 2020, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Z. Eset Berisha, shkarkohet nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

2. Z. Arianit Islami, emërohet U.D. i Drejtorit të Përgjithshëm, deri në emërimin e drejtorit të ri, pas marrjes së propozimeve nga Ministri i Infrastrukturës dhe Ambientit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

4. Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të ushtrojë padi të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamentin për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh pas publikimit të këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A R S Y E T I M

Ligji nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (LAC), neni 20.1(vi) përcakton që *"Drejtori i Përgjithshëm është person me integritet të lartë moral dhe personal"*. Neni 20.4 pika a) i po këtij Ligji thekson që *"Para skadimit të mandat të Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së, Qeveria mundet me vetë-iniciativë ose pas propozimit të Ministrit ta shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm ndër të tjera nëse ai/ajo: (a) ka bërë shkeljen e detyrave të tij/saj profesionale; ose (e) angazhohet në një biznes, profesion, ose marrëdhënie tjetër pune."*

Arsyet që kanë sjellë deri te shkarkimi i z. Eset Berisha janë si vijon:

1. Shkelja e detyrave profesionale

- *Hartimi dhe nënshkrimi i Rregullores së brendshme të AAC-së në kundërshtim me ligjin;*
- *Ri-sistemimi i stafit menaxhues në kundërshtim me ligjin (degradimi i tyre pa vlerësim të performancës);*
- *Mos-nënshkrimi i raportit vjetor të punës nga Bordi Mbikëqyrës (që tregon për pakënaqësitë me parregullsitë dhe shkeljet e detyrave të drejtorit);*

- *Mbajtja e detyrave tjera me pagesë njëkohësisht;*
- *Rrezikimi potencial i Qeverisë së Republikës së Kosovës në arbitrazh.*

2. Emërimi i kundërligjshëm i Z. Eset Berishës si Drejtor i Përgjithshëm i AAC-së.

3. Konflikti i interesit me veturat e Bechtel-Enkas.

Secila prej arsyeve të cekura në arsyetim, është e elaboruar në memorandumin shpjegues të bashkëngjitur këtij vendimi. Marrë parasysh gjithë këtë, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

**Albin KURTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Z. Eset Berisha
- Z. Arianit Islami
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada – Government*

I nderuar Kryeministër Kurti,

Të nderuar ministra,

Anëtarë të ndryshëm të Kabinetit të Kryeministrit janë kontaktuar në vazhdimësi nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), konkretisht zyrtarë të lartë përbrenda AAC-së. Kontaktet janë drejtuar me qëllim informimi mbi shkeljet flagrante të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, z. Eset Berisha dhe kërkesa e tyre konform legjislacionit në fuqi, ka shprehur nevojën për ndërmarrjen e hapave institucional ndaj kësaj situate të krijuar.

Në respektim të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, ka për interes zbatimin e plotë të saj dhe të ndalojë e ndërprejë cfarëdo tentative atëherë kur ai ligj shkelet, keqpërdoret ose nuk respektohet. Prandaj, në hulumtim dhe shqyrtim e sipër të këtyre shkeljeve nga Zyra e Kryeministrit është vërejtur që këto shkelje të prezantuara, për më tepër përbejnë shkelje që janë në linjë me paragrafin 4, pikën a të Nenit 20 të Ligjit për Aviacionin Civil që domosdoshmerisht kërkojnë shkarkimin e z. Eset Berisha.

**Si Zëvendëskryeministër i Republikës së Kosovës, tek i cili së pari kanë ardhur këto kërkesa, konsideroj që Qeveria ka bazë të mjaftueshme që duke u bazuar në Nenin 20, par 4 të LAC me vetëiniciativë të shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, z. Eset Berisha.**

**Arsyet që konsideroj se e bëjnë të nevojshme një shkarkim të tillë, janë si vijon:**

Autoriteti i Aviacionit Civil është agjenci rregullatore e sigurisë së aviacionit civil (shih Nenin 130 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil, emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil.

Ligji nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (LAC), neni 20.1(vi) përcakton që "***Drejtori i Përgjithshëm është person me integritet të lartë moral dhe personal***". Neni 20.4 pika a) i po këtij Ligji thekson që *"Para skadimit të cilitdo mandat [të Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së] Qeveria mundet me vetë-iniciativë ose pas propozimit të Ministrit ta shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm vetëm nëse ai/ajo: (a) ka bërë shkeljen e detyrave të tij/saj profesionale; [...] ose (e) angazhohet në një biznes, profesion, ose marrëdhënie tjetër pune."*

Z. Berisha ishte emëruar jashtëligjshëm në krye të Autoritetit të Aviacionit Civil, përmes paraqitjes së rreme të përvojës së punës në nivel drejtues dhe kjo është dëshmuar me dokumentacion përtej cdo dyshimi të bazuar, por në kuptim të nenit 20.4 pika a) për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, z. Berisha si Drejtor i Përgjithshëm i AAC-së ka kryer një varg shkeljesh në raport me stafin dhe operatorët që i rregullon dhe është përfshirë në një numër skandalesh që kanë bërë që Qeveria e Republikës së Kosovës të vërejë që z.Berisha ka bërë shkeljen e detyrave të tij profesionale duke plotësuar kështu kushtin e përcaktuar në Nenin 20 paragrafi 4 për shkarkimin e parakohshëm. Përveç tjerash, z.Berisha ka shkaktuar pasiguri juridike në institucionin që drejton, e cila mund të reflektojë në pasiguri operacionale të operatorëve, sigurinë e të cilëve AAC e mbikëqyr.

## 1. Shkelja e detyrave profesionale

### a) *Hartimi dhe nënshkrimi i Rregullores së brendshme të AAC-së në kundërshtim me ligjin*

Që në fillim të marrjes së detyrës më 11 janar 2019, pa ndonjë vlerësim apo rekomandim profesional nga institucionet përgjegjëse të shtetit apo organizmat ndërkombëtarë ndaj të cilëve AAC-ja ka detyrime kontraktuale, më dt. 29 janar 2019, z. Berisha nxori *Vendim Nr. Ref. 05/2019*[1] për hartimin e Rregullores për organizimin e brendshëm të AAC-së, vendim i paligjshëm si në aspektin formal ashtu edhe material, sic do të elaborohet më poshtë në dokument. Që në fillim duhet theksuar se Raporti i auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit i vitit 2018[2] për AAC-në ka rezultuar pa asnjë gjetje dhe pa asnjë rekomandim. Fushëveprim i auditimit ka qenë edhe struktura organizative.

Në kundërshtim me *nenin 10 par. 1.3 të Rregullores nr. 09/2012 për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administraten shtetërore,* z. Eset Berisha ka caktuar kryesues të Komisionit për hartimin e rregullores, z. Xhelil Bekteshi, Zv. Drejtor i përgjithshëm në AAC, një të emëruar politik *(Shih Vendimin nën fusnotën 1),* përderisa sipas rregullores në fjalë kërkohet të jetë nëpunës civil. Vendimi për Komisionin për hartimin e Rregullores i ka

[1] Vendim mbi caktimin e Komisionit për hartimin e Projekt-rregullores së brendshme të AAC-së,nr.05/2019, dt. 29 janar 2019
[2] Raporti i ZKA për AAC për vitin 2018.

përcaktuar Komisionit afat kohor prej 30 ditësh për hartimin e projekt-rregullores. Disa muaj pas kalimit të afatit të përcaktuar me vendim, kryetari i Komisionit ka dorëzuar më 8 korrik 2019 një draft, pa shkresë përcjellëse të nënshkruar nga komisioni. Pra, nuk ka asnjë evidencë materiale se drafti i rregullores ka qenë produkt i punës së komisionit. Megjithatë, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së e ka nënshkruar një Rregullore të brendshme të AAC-së më datë 09.07.2019, gjashtë muaj pasi do të duhej të pranonte draftin e rregullores, me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga Komisioni hartues. Rregullorja e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së nuk i është nënshtruar konsultimit publik siç kërkohet me Rregulloren (QRK) nr. 05/2016 për Standardet minimale për Procesin e konsultimit publik, ndërsa Shtojca 1 e kësaj rregulloreje të brendshme të AAC-së, që përshkruan detyrat e punës së personelit, nuk është bërë publike[3]. As sot nuk dihet procesi i hartimit dhe miratimit të Rregullores së brendshme të AAC-së, që i përcakton fundamentet e kësaj agjencie.

Rregullorja ishte e parakohshme dhe në kundërshtim me ligjin, sepse sipas nenit 28 par. 6 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (LOFASHAP), miratimi i rregulloreve të brendshme për tërë administratën shtetërore, do duhej t'i referohej aktit nënligjor nga Qeveria, i cili do të përcaktonte dispozitat rreth hartimit dhe hyrjes në fuqi të këtyre rregulloreve të brendshme nëpër institucionet e shtetit. Në kohën kur Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së e kishte miratuar Rregulloren e brendshme të AAC-së, Qeveria ende nuk e kishte nxjerr aktin nënligjor, si detyrim zbatues i nenit 28 par. 6 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin LOFASHAP.

Sipas nenit 42 të Ligjit Nr. 06/L-113 për LOFASHAP, edhe sikur të ishte në fuqi akti nënligjor i Qeverisë për rregullimin e kësaj fushe, para miratimit të rregullores nga z. Berisha, poashtu do të duhej të merrte rekomandim nga Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Financave (MF) dhe Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

**Mendimi këshillimor/ rekomandimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit** dt. 27.05.2019 ishte që *"Klasifikimi dhe klasat e vendeve të punës duhet ti referohen ligjit nr. 06/L-111 për Paga në Sektorin Publik"*, ligj i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese.[4]

[3] Rregullore për organizimin e brendshëm https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20666
[4] Mendimi këshillimor/rekomandimi nga Zyra Kombëtare e Audimit, dt. 27 maj 2019

Më dt. 10 qershor 2019, **MAP, me shkrim i kishte rekomanduar** Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, se "*AAC-ja duhet të vazhdojë punën e saj në bazë të organizimit të brendshëm aktual të saj, deri sa aktet nënligjore që do vendosin rregullat dhe standardet e organizimit të brendshëm të administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, duke iu referuar procesit ligjor dhe reformator të administratës shtetërore të racionalizimit të agjencive të pavarura*".[5]

Rekomandim nga Ministria e Financave nuk ishte marrë fare edhe pse ishte i detyrueshëm me Ligj.

Nga kjo konkludohet se Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së nuk ka respektuar rekomandimin e MAP-it dhe Auditorit të Përgjithshëm, ndërsa rekomandim nga MF-ja nuk kishte marrë fare, por megjithatë, si pasojë, kishte aprovuar rregulloren e brendshme të AAC-së në kundërshtim me Ligjin.

### b) *Ri-sistemimi i stafit menaxhues në kundërshtim me ligjin (degradimi i tyre pa vlerësim të performancës)*

Më dt. 17.07.2019, në zbatim të Rregullores së referuar në pikën a) më lart, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së filloi me ri-sistemimin e stafit menaxhues në pozitat e reja, duke nxjerr Vendime individuale, *(nr. Ref: 19/2019, nr. Ref: 14/2019, nr. Ref: 15/2019 nr. Ref: 18/201.. etj)*[6], të cilët i ulin në pozitë 4 nga 6 Drejtorët e Departamenteve të AAC-së (tre nga Drejtor Departamenti në u.d. Udhëheqës Divizioni dhe në një rast nga Drejtor Departamenti në Udhëheqës njësie). Të gjithë këta kishin vlerësime shumë të mira të punës për vitin 2018.[7]

Vendimet e dt. 17.07.2019 nuk kishin përfillur dispozitat përkatëse ligjore, përveç tjerash, nga fakti se iu mungonte arsyetimi dhe këshilla juridike *(Shih Ligjin 05/L-031 të procedurës së përgjithshme administrative. Nenet 47-48 përmendin arsyetimin dhe këshillën juridike si elemente të aktit administrativ, kurse neni 52.1.4 thotë se akti është i paligjshëm kur i mungojnë elementet formale).* Nëpunësve të AAC-së, të degraduar me këto vendime, iu është pamundësuar edhe ankimimi, sepse Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, e kishte themeluar përmes një Vendimi[8] posa kishte marrë mandatin, Komisionin e Ankesave

[5] Provë: Rekomandimi i MAP, dt. 10 qershor 2019
[6] Provë: vendimet e bashkëngjitura
[7] Provë: Vlerësimet vjetore të punës për vitin 2018 për Lendita Kikën, Besnike Ukmatën, Hysa Matoshin dhe Burim Dinaramën.
[8] Provë: Vendimi nr. 6/2019 për themelimin e KZKA, dt. 29 janar 2019

(KZKA) me anëtarë të angazhuar nga Ministria e Infrastrukturës me kontrata mbi vepër, dy prej të cilëve u kishin skaduar ose do t'u skadonin shumë shpejtë kontratat për shërbime të veçanta në Ministrinë e Infrastrukturës. Zyrtarët e degraduar të AAC-së megjithatë kanë parashtuar ankesa në vendimet e referuara më lart, dhe pas skadimit të afatit për trajtim të ankesave nga KZKA, Drejtori i Përgjithshëm përmes Menaxheres së personelit znj. Safete Selmani njoftoi stafin më 27 shtator 2019[9] se anëtarëve të komisionit të ankesave iu ka skaduar kontrata e punës, duke ua mohuar kështu të drejtën e ankesës. Cenimi i së drejtës për ushtrimin e mjetit juridik përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Vendimet e dt. 17.07.2019 ishin nxjerr duke u mbështetur në **neni 30 par. 4 të Ligjit për Shërbimin Civil** me afat 3 muaj. *"Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj"*. Ky afat ka përfunduar me dt. 17.10.2019, por edhe pas kësaj date, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, nën kërcënim me masa disiplinore më 10 janar 2020 i ka detyruar zyrtarët e degraduar të vazhdojnë punën sipas pozitave të caktuara me vendimet e skaduara dhe nuk i ka kthyer nëpunësit në pozitat e përcaktuara në Akt emërimet **pa afat**, nga themelimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil të Republikës së Kosovës[10].

Drejtorët e degraduar të departamenteve të AAC-së, nuk janë lejuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së t'i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, sipas ligjeve, akteve nënligjore, akt emërimeve, përshkrimit të vendit të punës, sic ishin të regjistruar në sistemin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (ish MAP) dhe në Ministrinë së Financave. Zyrtarët e referuar, edhe pas skadimit të vendimeve për emërim të përkohshëm si ushtrues detyre, detyrohen nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së të vazhdojnë punën si ushtrues detyre të divizioneve që kishte krijuar. Kjo situatë ka krijuar Pasiguri juridike në Autoritetin e Aviacionit Civil, që si pasojë, mund të cënojë sigurinë publike, duke marrë parasysh rolin e AAC-së, të përcaktuar në ***Kapitullin XI [SEKTORI I SIGURISE], neni 130, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*** Shumica e stafit të degraduar janë staf i shkolluar në lëminë e aviacionit dhe me përvojë pune në mbikëqyrje të aviacionit që nga paslufta. Injorimi i rekomandimeve të IAP të cilat sipas ligjit janë të obligueshme

[9] Provë: Email nga Menaxherja e burimeve njerëzore znj. Safete Selmani, dt. 27 shtator 2019

[10] Provë: Shkresa e z. Berisha drejtuar stafit lidhur me detyrimin për përdorimin e titujve në vendimet e skaduara, dt. 10 janar 2020

Në këtë drejtim edhe **Institucioni i Avokatit të Popullit** ka nxjerr Raport dt. 09.03.2020, A. nr. 993/2019[11] kundër Autoritetit të Aviacionit Civil në lidhje me kushtin diskriminim në punë drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, ku ka konstatuar një numër të shkeljeve të detyrave të punës si më poshtë:

1. Zbatimi i Rregullores për organizimin e brendshëm, datë 9 korrik 2019 nga AAC-ja nuk është në përputhje me Ligjin nr. 06/L-113 përkatësisht Nenin 28 të saj,
2. Vendimi nr.15/2019, Vendimi nr. 18/2019, Vendimi nr. 19/2019, Vendimi nr. 14/2019 të datës 17 korrik 2019 të nxjerra nga Drejtori i përgjithshëm i AAC nuk janë në përputhje me nenin 50 të Ligjit nr. 03/L-049 për shërbimin civil ku përcakton: 'Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo cdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrtive, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës''
3. Ricaktimet e vendeve të punës së nëpunësve janë në kundërshtim edhe me nenin 28.2 të Ligjit nr. 03/L-049 i cili përcakton se 'Nëpunësit civilë mund të caktohen, si masë jo disiplinore, në mënzrë të përkohshme ose të përhershme në vende tjera pune **për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori funksionale dhe gradë'.**
4. AAC ka dështuar të ofrojë prova bindëse se me riorganizimin e AAC, në përputhje me Rregulloren e brendshme, datë 9 korrik 2019, i ka trajtuar nëpunësit pa diskriminim dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi **për shkak të mendimit politik apo të mendimeve tjera**, e drejtë e garantuar edhe me nenin 43 të Ligjit për shërbimin civil
5. Drejtori i përgjithshëm i AAC, përmes vërejtjeve të shqiptuara kundër nëpunëses, me argumente se ka parashtruar ankesë për diskriminim jashtë AAC, është në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit nr. 05/L-021 pë mbrojtje nga diskriminimi i cili në paragrafin 1.5 parasheh: ' Viktimizimi konsiderohet diskriminim mbi bazat e përcaktuara në nenin 1 të këtij Ligji dhe ndodh kur personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim ndaj ankimit apo mos ankimimit (procedurave të filluara) apo veprimeve me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë...' **përbën shkelje të trajtimit të barabartë të bazave të përmendura në nenin 1 të këtij Ligji prandaj përbën diskriminim.**

Duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në AAC, në bazë të këtyre gjetjeve dhe në bazë të nenit 135, paragrafit 3, të Kushtetutës së Republikës së

[11] Provë: Raport me rekomandime i Avokatit të popullit A. nr. 993/2019 kundër Autoritetit të Aviacionit Civil

Kosovës dhe të nenit 16.4 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka rekomanduar si vijon:

1. Autoriteti i aviacionit civil ti anulojë Vendimet nr. 15/2019, nr. 18/2019, nr. 19/2019, nr. 14/2019 të datës 17 korrik 2019 të nxjerra nga Drejtori i Përgjithshëm të cilat shkelin nenin 50 dhe nenin 28 të Ligjit për shërbimin civil të RKS
2. Autoriteti i aviacionit civil ta zbatojë legjislacionin në fuqi dhe ti eliminojë të gjitha shkeljet ligjore të konstatuara nga Avokati i Popullit në këtë raport
3. Autoriteti i aviacionit civil ta respektojë nenin 20 të Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi në argumentimin e pretendimeve të nëpunësve për shkelje të të drejtave të punës, ushtrimit të profesionit, diskriminimi në bazë të përkatësisë politike, mendimit politik si dhe gjinor në marrëdhënie pune.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së RKS ('*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës është i detyruar t'i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj*') dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit ('*Autoritetet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete,... duhet të përgjigjen brenda afatit 30 ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*'). Sipas nenit 61 paragrafi 3 të Rregullores nr. 02/2016 së punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, në përputhje me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit, autoriteteve që Avokati i Popullit ju rekomandon duhet të përgjigjen brenda 30 ditëve me veprime konkrete sipas rekomandimeve. Neni 62 i po të njejtës Rregullore thekson, nëse rekomandimet nuk zbatohen nga autoriteti administrativ apo zyrtarët përkatës që në këtë rast është përpos AAC edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (Qeveria) si organ ekzekutiv, Avokati i Popullit ia adreson çështjen Kuvendit të Kosovës dhe mund të bëj Deklaratë Publike për mos zbatim të Raportit me rekomandime.

Afati për zbatimin e rekomandimeve ka skaduar më 9 prill 2020 dhe Drejtori i përgjithshëm i AAC nuk ka zbatuar asnjë rekomandim të Avokatit të Popullit të listuar më lart.

### *c) Mos-nënshkrimi i raportit vjetor të punës nga Bordi Mbikëqyrës (që tregon për pakënaqësitë me parregullsitë dhe shkeljet e detyrave të drejtorit)*

**Bordi Mbikëqyrës** i AAC-së më dt. 22.04.2020 ka konstatuar **"Situatë të Pasigurisë Juridike"** në Autoritetin e Aviacionit Civil si pasojë e veprimeve të Drejtorit të Përgjithshëm, të cilat përfshijnë edhe mospërfilljen e rekomandimeve të Bordit Mbikëqyrës të AAC-së nga Drejtori i Përgjithshëm, të dalura nga mbledhjet e rregullta të këtij Bordi. Si rrjedhojë, Bordi Mbikëqyrës i AAC-së nuk e ka miratuar Raportin vjetor të AAC-së për vitin 2019[12].

Duke u nisur nga përgjegjësia që Bordi Mbikëqyrës ka në bazë të Ligjit për aviacionin civil, i është drejtuar me shkresë Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Kryetares së Kuvendit të Kosovës për të parë nëse veprimet e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së me rastin e riorganizimit të AAC-së, janë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.[13]

### *d) Mbajtja e detyrave tjera me pagesë njëkohësisht*

Ligji për Aviacionin Civil, neni 20.4, përcakton që posti i Drejtorit të Përgjithshëm është post me orar të plotë ndërsa njëra nga arsyet për shkarkim nën piken 20.4(e) është edhe nëse *"ai/ajo angazhohet në një biznes, profesion, ose marrëdhënie tjetër pune"*. **Pra angazhimi me orar të plotë në AAC si Drejtor i përgjithshëm përjashton çfarëdo angazhimi tjetër me pagesë.**

Megjithatë, edhe pas zgjedhjes më 11 janar 2019 në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, z. Eset Berisha ka vazhduar ta mbajë pozitën e:

1. *Kryesuesit të Komitetit të Auditimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit dhe*
2. *Anëtarit të Njësisë zbatuese të autostradës R6 "Arbën Xhaferi" (Prishtinë – Han i Elezit).*

Pas emërimit të z. Eset Berisha si Drejtor i Përgjithshëm i AAC-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 11.01.2019 ( vendimi i bashkëngjitur[14]), Ministri Pal Lekaj, përmes Vendimit 032/19 dt.

[12] Provë: Email i dt. 21 prill 2020 nga anëtari i Bordit Mbikëqyrës drejtuar Eset Berishës lidhur me mosaprovimin e Raportit Vjetor
[13] Provë: Shkresë e dt. 22 prill 2020
[14] Vendimi nr. 07/83 i QRK mbi emërimin e Eset Berishës Drejtor i Përgjithshëm i AAC

12.01.2019[15], ia heq z. Eset Berisha përgjegjësitë e Këshilltarit të tij politik, por jo edhe përgjegjësitë tjera që i kishte marrë përsipër sa ishte në Ministri, siç është roli në Komitetin e Auditimit dhe në Njësinë zbatuese të autostradës, për të cilat Eset Berisha është kompensuar me pagë edhe pas marrjes së detyrës si Drejtor i Përgjithshëm i AAC-së. Ky vendim në pikën II thotë: "*Z. Berisha lirohet nga të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që ndërlidhen me funksionin e këshilltarit politik, ndërsa funksionet tjera të cilat z. Berisha i ushtron sipas vendimeve te vecanta, do të mund t'i ushtrojë si anëtar i jashtëm, vetëm në rast se nuk paraqesin konflikt interesi.*"

Në detyrën që mban në kuadër të Komitetit të Auditimit, z. Eset Berisha ka edhe konflikt interesi, sepse mbikëqyr auditimin e Ministrisë që AAC-së ia përcakton politikat.

Në një artikull të Kohës Ditore të dt. 14 dhjetor 2019[16] Eset Berisha thotë se mban veturë në kuadër të detyrave të Njësisë zbatuese për këtë autostradë. Kjo është pozitë e shërbimit civil, pra Eset Berisha mbanë dy pozita në administratë publike (mbajtja e kësaj pozite të shërbimit civil si këshilltar politik i ministrit poashtu ishte në kundërshtim me Ligjin e Aviacionit Civil, si ligj specifik dhe drejtori është i detyruar ta respektoj). Për mbajtjen e këtyre pozitave Eset Berisha ka marrë kompensim financiar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Trasportit (bashkëngjitur dëshmia për pagën shtesë për angazhimin në njësinë zbatuese). **Në administratën publike nuk lejohen dy punë (paga) të ndryshme.** Paga shtesë për pozitën e njëjtë lejohet sipas Rregullorës (QRK) 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, me konfirmim të MAP dhe MF, gjë që nuk është bërë në këtë rast.

Në artikullin e Kohës thuhet se zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës po vozisin veturat që kompania Bechtel Enka u kishte vënë në dispozicion Njësisë zbatuese të autostradës "Arbën Xhaferi" (Prishtinë – Han i Elezit). Gazeta citon zyrtarin e Ministrisë, z. Lahudin Myrtaj, të pranojë që anëtarët e njësisë kishin marrë këto vetura në përdorim për "monitorim" të kontratës. Njëri nga përdoruesit e këtyre veturave, edhe mbi një vjet pasi ka marrë detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, është edhe Drejtori i Përgjithshëm Eset Berisha, i cili vozit një veturë Land Rover të vënë në dispozicion me të gjitha shpenzimet nga Bechtel Enka (e konfirmuar nga disa sinjalizues, punëtorë të AAC-së).

[15] Vendimi nr. 032/19 dt. 12.01.19 i Ministrit Lekajt për pushimin e Mandatit të z. Berisha si këshilltar politik
[16] Zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës vozisin "Land Roverat" e "Bechtel-Enkas", dt. 14 dhjetor 2019, https://ëëë.koha.net/arberi/198978/zyrtaret-e-ministrise-se-infrastruktures-vozisin-land-roverat-e-bechtel-enkas/

Z. Eset Berisha për angazhimin e kundërligjshëm në Njësinë zbatuese për monitorimin e autostradës "Arbër Xhaferi", në muajin mars 2019 ka përvetësuar **5.515,57€ neto** ndërsa në muajin gusht i ka pervetësuar **7.995,08 € neto** për paga shtesë retroaktive, ndërsa më dt. 26.09.2019 për muajt korrik-gusht 2019 **MI ia ka paguar Eset Berishës 1.200€** pagë shtesë për detyrat në njësinë zbatuese të autostradës.[17] Duket se termi "pagë shtesë" është përdor qëllimisht nëpër pagesa që të krijohet bindja se bëhet fjalë për pagën shtesë për pozitën e njëjtë.

Në fakt Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së nuk merr shtesa nga vendi i punës së tij, por nga Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit dhe në në kundershtim me nenin 20.4 (e) të Ligjit të aviacionit.

### *f) Rrezikimi potencial i Qeverisë së Republikës së Kosovës në arbitrazh*

**Operatori privat i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, Limak Kosovo International Airport (LKIA) sh.a., ka dërguar njoftime për "political event" (ngjarje politike)**, apo njoftim se ata konsiderojnë që Qeveria e Republikës së Kosovës po e shkel kontratën e koncesionit.

Një njoftim e kanë bërë më 30 gusht 2019 për shkak të aprovimeve të përkohshme për shërbime në tokë të operatorit të aeroportit LKIA, të lëshuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil, dhe një tjetër më 12 dhjetor 2019, për shkak të aprovimeve të përkohshme për shërbime në tokë të furnizuesit me kerozin në aeroport, poashtu prej këtij Autoriteti.[18]

Çështja kyçe në kontest është që Drejtori i përgjithshëm i AAC-së Eset Berisha nuk po u jep aprovime afatgjate këtyre operatorëve, siç parashihet më Rregulloret e AAC-së, duke i vazhduar ato aprovime për periudha afatshkurtra, madje edhe një ditë para skadimit për LKIA, dhe pas i ka skaduar afati operatorit të autorizuar për furnizim të avionëve me karburant[19] , duke krijuar kështu pasiguri juridike për këto dy subjekte. Në ndërkohë, z. Berisha ka bërë aprovim për futje në treg të operatorëve të tjerë.

[17] Fatura 08-09/2019 EB sipas Vendimit (MI) 558/18 dt. 21.06.2018 dhe ky Vendim
[18] Provë: dy letrat nga LKIA ku njofton për ngjarjet politike
[19] Provë: Shkresa e operatorit për furnizim me karburant që tregon edhe për kallëzim penal

**Aprovimi teknik**, të cilin Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së e ka dhënë në vazhdimësi për periudha të shkurtra, dhe **qasja në treg** që rrjedh nga hapja e tregut, janë dy çështje të ndryshme dhe nuk duhet të ndërlidhen siç ka vepruar ai.

**Para se Eset Berisha të bëhej Drejtor i AAC-së, të dy këta operatorë kanë mbajtur Aprovime të lëshuara nga AAC-ja me validitet 7 vjeçar (2011-2018)**, në përputhje me procedurat në fuqi. Kjo ka vërtetuar se ata kanë përmbushur kushtet e sigurisë, sigurimit dhe qëndrueshmërisë financiare. Të dy operatorët janë inspektuar dhe mbikëqyrur vazhdimisht nga inspektorët e AAC-së, të cilët në çdo moment kur kishin vërtetuar se kriteret në bazë të të cilave janë aprovuar nuk po përmbushen, kanë pasur të drejtë t'úa revokojnë aprovimin. Por kjo nuk ka ndodhur sepse të dy operatorët kanë zbatuar rregullat në plotni.

## 2. Emërimi i kundërligjshëm i z. Eset Berishës si Drejtor i Përgjithshëm i AAC-së

Sipas Nenit 20 të LAC, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së emërohet nga Qeveria pas propozimit të Ministrit (Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit).

Neni 20.1 thotë:

*Drejtori duhet të posedojë kualifikimet në vijim:*

*a) Ai/ajo ka diplomë universitare,*
*b) **Ai/ajo ka pesë ose më shumë vite përvojë të konsiderueshme menaxhuese** dhe përvojë profesionale në fushën e aviacionit civil, etj.*

Në Memorandumin Shpjegues të Ministrit Lekaj[20], dhe në letrën që Eset Berisha ia kishte shkruar Ministrit Lekaj më 30 tetor 2018 përderisa i shërbente këtij Ministri si Këshilltar politik, me të cilin kishte njoftuar kandidaturën e tij, duke tentuar ta vërtetojë se ka përvojë menaxhuese të konsiderueshme siç kërkohet me nenin 20.1 të LAC, ai deklaron se ka punuar "nga viti 2010-2016 në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës në pozitën e udhëheqësit të zyrës për cështje juridike dhe rregullatore". Për të vërtetuar këtë përvojë menaxhuese, Eset Berisha kishte bashkëngjitur një "Vërtetim të dt. 6 tetor 2016" të lëshuar nga Menaxherja e Personelit në AAC, Safete Selmani, të

[20] Provë: Dosja e dorëzuar nga Ministri Lekaj Qeverisë me rastin e propozimit të z. Berisha për pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm KM-MI nr. prot 933/18 dt. 27/11/18

paprotokolluar[21], të dy këto vepra penale të falsifikimit dhe të legalizimit të përmbajtjes së rrejshme.

**a. Shkelja e kërkesave të pikës ii) të nenit 20.1 të LAC nga Eset Berisha**

Gjatë viteve 2010-2016, Eset Berisha ka mbajtur këto pozita në AAC siç dëshmojnë akt emërimet[22]:

- Jurist i aviacionit (fillon 1 gusht 2010)
- Këshilltar ligjor i aviacionit (fillon 1 gusht 2011)
- Udhëheqës i zyrës për çështje ligjore të aviacionit (fillon 05.10.2015-01.10.2016).

Kontrata e Punësimit/Akt Emërimet e tij për periudhën 2010-2016 si dhe përshkrimi i detyrave të punës vërtetojnë se Eset Berisha ka vetëm 1 vjet përvojë pune menaxheriale. Në Përshkrimin e detyrave të tij të punës të nënshkruar me rastin e marrjes së pozitës si Udhëheqës i zyrës për cështje ligjore të aviacionit në tetor 2015 shihet qartë se nuk ka pasur përgjegjësi të mbikëqyrjes meqenëse nuk ka pasur asnjë vartës as edhe vitin e tij të fundit dhe kjo është një zbrastësirë e madhe si në aspekt ligjor e po ashtu në aspektin e tij menaxherial dhe me jo kompetencë në udhëheqje. Theksojmë se LAC, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij institucioni të sigurisë, kërkon që **Drejtori i Përgjithshëm të ketë përvojë të konsiderueshme menaxheriale.**

Raportet vjetore në të cilat gjendet skema organizative e AAC-së ndër vite dëshmojnë se për vitin 2010 figuron pozita Jurist i aviacionit, në vitet 2011-2014 figuron pozita Këshilltar Ligjor i aviacionit, dhe në vitin 2015 figuron pozita Udhëheqës i zyrës për çështje ligjore të aviacionit pa asnjë vartës që raporton te kjo pozitë.

Për emërimin e Drejtorit në mënyrë të paligjshme dhe me dokumentacion të falsifikuar ka raportuar Koha Ditore, për të cilën kanë theksuar juristët se "ish këshilltari i Pal Lekajt jashtligjshëm është zgjedhur drejtor i aviacionit civil".[23] Policia e Kosovës ka filluar hetimet ndaj Eset Berishës edhe për falsifikim të përvojës menaxheriale.

3. ***Konflikti i interesit me veturat e Bechtel-Enkas***

[21] "Vërtetimi i dt. 6 tetor 2016" nga Menaxherja e Personelit në AAC, znj. Safete Selmani, pa protokoll.
[22] Akt emërimet e z. Berisha në AAC të viteteve 2010, 2011 dhe 2015.
[23] Ish-këshilltari i Pal Lekajt jashtëligjshëm është zgjedhur drejtor i Aviacionit Civil, thonë juristët https://ëëë.koha.net/arberi/206791/ish-keshilltari-i-pal-lekajt-jashteligjshem-eshte-zgjedhur-drejtor-i-aviacionit-civil-thone-juristet/

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
*Qeveria – Vlada – Government*

Më 14 dhjetor 2019 Koha Ditore ka raportuar se zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës po vozisin veturat që kompania Bechtel Enka u kishte vënë në dispozicion Njësisë Zbatuese të Projektit të autostradës "Arbën Xhaferi" (Prishtinë – Han i Elezit). Gazeta citon zyrtarin Lahudin Myrtaj të pranonte që anëtarët e njësisë i kishin marrë këto vetura në përdorim për "monitorim" të kontratës. Njëri nga përdoruesit e këtyre veturave, edhe mbi një vjet pasi ka marrë detyrën në AAC, është edhe Drejtori i Përgjithshëm Eset Berisha i cili vozit një veturë Land Rover të zi me targa 01-752-HM të vënë në dispozicion nga Bechtel-Enka. Ai këtë veturë e ka në dispozicion 24/7 orë në ditë dhe rregullisht është e parkuar para zyrave të AAC-së.

**Vënia në dispozicion e beneficioneve personale nga kompania e kontraktuar për Njësinë Zbatuese të Projektit që në teori do të duhej ta mbikëqyrte atë është *konflikt i rëndë i interesit*, veçanërisht kur dihet se kjo njësi i ka lejuar Bechtel-Enkas në një rast 39 milionë EUR shtesë nga ajo që kishte rekomanduar Hill International ndërsa në rastin tjeter kishte nënshkruar 49.5 milionë EUR shtesë për punë të negociuara me Bechtel-Enkan.**

Shpeshtësia e shkeljeve ka ndikuar që puna në AAC të mos zhvillohet në harmoni me ligjin.

**Bashkëngjitur sipas nr. të fusnotës:**

*1 - Vendim mbi caktimin e Komisionit për hartimin e Projekt-rregullores së brendshme të AAC-së, nr. 05/2019, dt. 29 janar 2019;*
*2 - Raporti i ZKA për AAC për vitin 2018;*
3 - Rregullore për organizimin e brendshëm https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20666
*4 - Mendimi këshillimor/rekomandimi nga; Zyra Kombëtare e Audimit, dt. 27 maj 2019;*
*5 - Rekomandim nga Ministria e Administratës Publike, dt. 10 qershor 2019;*
*6 - Vendimet nr. Ref: 15/2019, nr. Ref: 19/2019, nr. Ref: 18/2019, nr. Ref: 14/2019;*
*7 - Vlerësimet vjetore të punës për vitin 2018 për Besnike Ukmatën, Hysa Matoshin dhe Lendita Kikën;*
*8 - Vendimi nr. 6/2019 për themelimin e KZKA, dt. 29 janar 2019;*
*9 - Email nga Menaxherja e burimeve njerëzore znj. Safete Selmani, dt. 27 shtator 2019;*

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**
*Qeveria – Vlada – Government*

*10 - Shkresa e z. Berisha drejtuar stafit lidhur me detyrimin për përdorimin e titujve me vendimet e skaduara, dt. 10 janar 2020;*
*11 - Raport me rekomandime i Avokatit të popullit A. nr. 993/2019 kundër Autoritetit të Aviacionit Civil, dt. 09 mars 2020;*
